

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Nga salla plot e Kuvendit po diskutojmë pas një dite të gjatë të lodhshme. Si përherë deputetët kanë shumë ngarkesa dhe shumë punë dhe në përgjithësi salla është kështu. Mund të dukemi edhe si të lajthitur që diskutojmë për një moratorium për gjuetinë, ndërkohë që gjuetia e njerëzve është kthyer në shqetësimin kryesor në këtë vend, njerëzit gjuhen sikur të jenë kafshë në çdo cep të territorit të Shqipërisë pa pyetur për autoritetin e shtetit dhe të institucioneve shtetërore. Nga ana tjetër përfaqësuesit e qeverisë thonë se u përpoqën të përmbledhin diçka. Do t'ju lutesha, duke qenë se vazhdon kori i shkollës prapa, të përmbledhni arrogancën në raport me çdo përfaqësues të qytetarëve në këtë vend.

Për etiketime personale, për barsolleta ose për të kthyer në meme për rrjetet sociale, nuk kanë nevojë se janë kthyer vetë. Nuk duhet të flitet me prepotencë për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, siç foli kolegja parafolëse. Për çështje konkrete dhe me argumente konkrete këta flasin me një prepotencë dhe arrogancë sikur janë baballarët dhe nënat e kombit, sikur gjithçka që bën qeveria është e drejtë dhe gjithçka që thuhet kundër tyre është e gabuar dhe e padrejtë, sikur gjithçka dhe të gjithë që thonë diçka kundër qeverisë janë njerëzit me cene në pamje, me cene në personalitet, me cene në profesion, ndërkohë që këta, të shkëlqyerit e dynjasë, janë aty.

Nuk do të çohesha të flisja në këtë sallë, pas një kalvari të gjatë debatesh, nëse nuk do të takoja një grup gjuetarësh që kishin shqetësim moratoriumin e vendosur nga qeveria, një moratorium, i cili të vetmin shqetësim që kishte në momentin e miratuar ishte të kujdesej për atë që kemi denoncuar prej vitesh në këtë Kuvend dhe që tashmë është vendosur edhe nga gjykata dhe nuk ka njeri që nuk e di, nga shqetësimi i qeverisë që të mos shkeleshin territoret e mbushura me kanabis sativa në çdo cep të territorit të Republikës. Shoqata e gjuetarëve dhe gjuetarët kanë

shqetësim që moratoriumi i gjuetisë të mos vendoset dhe të mos jetë monopol, si gjithçka në këtë vend.

Sot do të votohet që edhe gjuetia të jetë monopol i qeveritarëve, i njerëzve të lidhur me atë, sepse e dinë të gjithë se gjuetia në Shqipëri nuk është e ndaluar për ata që janë të fortë. E dinë të gjithë që gjuetia vazhdon dhe dyfeku kërcet kudo, por është e ndaluar për të pamundurit për ata të cilët e kanë pasion. Pasioni i tyre duhej të bënte që qeveria të gjente një zgjidhje të ndërmjetme që edhe ata të gjuanin qoftë në zona të caktuara, qoftë duke i rritur dhe kujdesur vetë në zona të caktuara, sipas propozimeve që vetë ata kanë bërë për të bërë të mundur një gjë të ndërmjetme. Çfarë është kjo prerje me thikë dhe kjo prepotencë që po vendosim? U tha nga të gjithë kolegët kudo ka në treg kafshë të egra, ka në çdo cep të territorit.

Gjithashtu shikohen gjuetarë të vendeve fqinje, por edhe më tej që vijnë e gjuajnë në Shqipëri, por për ta nuk ka asnjë problem. Pse është ky shqetësim për të goditur disa njerëz që e kanë pasion? Ata janë me mijëra dhe nuk vrasin e shfarosin siç ndodh sot me disa njerëz që dalin dhe gjuajnë në mënyrë të paligjshme me drita, me mjete që nuk funksionojnë. Ndërkohë që diskutojmë për këtë moratorium sikur është shqetësimi më i madh, në rrugët me më shumë ngarkesë në fundajë, dhe akset kryesore të Veriut vriten tre të rinj. Nuk dua t'u hyj problemeve që ata kanë me ligjin, të cilat lindin edhe për shkak të politikave të kësaj qeverie, sepse i kanë detyruar të rinjtë që jetojnë këtu të pasurohen shpejt, të shohin si model pasurimi vetëm marrjen me drogë, të shohin si model pasurimi vetëm përfshirjen në veprimtari të paligjshme dhe ndërkohë qeveria nuk ekziston fare, sepse kontrollin në territor e kanë bandat në ato zona.

Ashtu siç në shumë zona të Shqipërisë qeveria jo vetëm i përkëdhel, por shefat e komisariateve drejtorët në zona, siç i faktua në Vlorë, i vendosin bandat e krimit të organizuar për të pasur kontroll. Dhe qeveria nuk jep asnjë mesazh pavarësisht se ngjarja është e kësaj jave. Nuk jep asnjë mesazh që, të paktën, të marrin mesazh të gjithë të tjerët që përgatiten për të gjetur gjueti. E kam thënë edhe një herë tjetër dhe po e përsëris sot: po çfarë është ky shtet ku banditët gjejnë njëri-tjetrin, por nuk i gjen dot qeveria që ka miliona euro në dispozicion, që ka infrastrukturë dhe institucione të ngritura, por nuk i gjen dot? Po çfarëdo të thotë kjo? Kjo do të thotë që nuk i gjen dot apo ka korrupsion, apo ka përkëdhelje, apo u jep dorën?

A ka njeri që nuk e kupton që të gjithë emrat që përfliten në kronikën e zezë dhe që bëjnë zi dhe sterrë të gjithë Shqipërinë janë të gjithë emrat që ne pa dashur, pa pasur dëshirë të madhe i kemi përmendur si njerëz të përfshirë në veprimtari kriminale, por të një veprimtarie ende më kriminale për Shqipërinë në shitblerje votash kërcënim votuesish në intimidim të votuesve?! Çdo person që del ne kronikën e zezë të Shqipërisë janë personat që kanë mbledhur vota për Partinë Socialiste. Grupet kriminale që kanë grumbulluar miliona euro, i vendosin çmim cilitdo dhe i japin mesazh cilitdo, edhe neve këtu këtë sallë, edhe jashtë saj, janë njerëzit më të mbrojtur me vrasje të tipit sikur të kenë ushtri, siç ndodhi vrasja në rrugën e Fushë-Krujës, ata mund t'i vendosin objektiv cilitdo dhe kjo është gjuetia njerëzore, ndërkohë që ne diskutojmë për gjuetinë, moratoriumin dhe për të ndaluar gjuetinë e kafshëve.

Të bëhemi bashkë dhe të japim mesazh të ndalojmë gjuetinë njerëzore duke ndaluar veprimtaritë kriminale, duke ndëshkuar, duke dhënë mesazh dhe duke çliruar edhe mijëra punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët e bëjnë punën me nder dhe janë të tradhtuar edhe nga drejtuesit politikë të policisë, por janë edhe nën kërcënimin e bandave kriminale që përkëdhelen, ulen hanë dhe pinë me përfaqësues të Partisë Socialiste si njerëz që kanë më shumë influencë në zonat e tyre, që vendosin edhe vendet e punës në administratën publike. Në këtë Shqipëri jemi sot, ku monopolet po ashtu i kanë ata, si edhe monopolin në gjueti. A pyet njeri këtu nga këta që vrasin njerëz se u vendoska moratorium për gjuetinë në Kuvendin e Shqipërisë?

Dhe nga kjo qenka rritur numri i zogjve ose i kafshëve të tjera në Shqipëri, por nuk po pyesin, po vriten njerëz dhe as nuk i parandalon dot policia, por as nuk zbardh dot pasi ndodhin, por është vetëm si agjenci lajmesh që vetëm lajmëron se u dogj kjo makina aty, u kapën këto armët këtu, ishin kaq njerëz aty dhe identifikimin e viktimave e bëjnë kollaj mediet edhe më shpejt se Policia e Shtetit. E për shkak të kësaj gjendjeje dhe për shkak të kësaj politike që prodhoni ju, Shqipëria është në këtë gjendje të mjeruar, ku pa diskutim edhe çelja e negociatave duhet thënë se është për shkak të qëndrimit gjeopolitik. Duheshin përshëndetur edhe deklarata para se të hapeshin negociatat edhe shtesa e fortë e sekretarit amerikan të shtetit, SHBA-ve dhe BE-së.

Nëse do të ishte për shkak të Shqipërisë, nëse do të ishte për shkak të plotësimit ose mosplotësimit të kushteve të Shqipërisë do të hapej shampanja këtu në mënyrë të përvitshme, do të shpërthenin fishekzjarrët nga Rama dhe do të duartrokiteshin nga kolegët e Partisë Socialiste, si fitore e madhe, për t'u thënë njerëzve që kemi fituar ndonjë gjë, por, ndërkohë, as negociata nuk do të kishte, as ndonjë e mirë për qytetarët nuk do të ndodhte. Faleminderit!